6. VKM nr. 826, datë 5.12.2011 "Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 "Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë", ndryshimi i pikës 9-të në këtë vendim përjashton dhënien e shpërblimeve të punonjësve për rezultate në punë dhe veprimtari social- kulturore. (Ndryshimi i këtij vendimi në datën 17.11.2011 e bën të pamundur rialokimin e fondeve të planifikuara për shpërblie nga "Fondi i Vecantë" të

rishpërndahen në programe apo aktivitete të tjera sepse bie ndesh me pikën 135 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

III - ARSIMI I MESËM I PËRGJITHSHËM. (Titulli i programit 09230)

Buxheti për këtë program kap vlerën **5 miliard e 267.7 milion lekë me 13.3 %** të buxhetit të MASH. Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011 në këtë program është në masën 5 miliard e 137.2 milion lekë ose në masën 98 % dhe përfaqëson rreth 13.6% të totalit fondeve të planifikuara për MASH dhe 13.9% të fondeve të realizuara për MASH.

Objektivat kryesorë:

1. Rritja e cilësisë së mësimdhënies me qëllim që, deri në vitin 2020 të arrihen standardet e vendeve të BE.
2. Përmirësimi i standardeve të infrastrukturës në gjimnaze, 10% e klasave ndaj totalit ekzistues do të rehabilitohen, 5%-10% e klasave ndërtohen të reja, 15 % e shkollave do të pajisen me laborator shkencor(CBA).
3. Pasurimi i bibliotekave në të gjitha shkollat.
4. Pajisja me laboratorë virtuale e rreth 25% të shkollave të mesme të përgjithshme për çdo vit të PBA.
5. AMP ta ndjekin 70% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë (25% ndjekin arsimin profesional.
6. Trajnimi i 50 mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kultures shqipe në diasporë. (Në mbështetje të Strategjisë Nr. 461, datë 9.6.2010, të miratuar nga Këshilli i Ministrave).

Arritje 2011

- ✚ **Në arsimin e mesëm të përgjithshëm**, vazhdon konsolidimi i cilësisë së Maturës Shtetërore, e cila konsiston në 4 provime për rreth 42 000 maturantë (2 provime të detyruara dhe 2 provime me zgjedhje). Për herë të parë nxënësit që përfunduan me sukses Maturën Shtetërore gjatë vitit 2011 u pajisen me diplomë të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP); çdo diplomë përmban të njëjtin numër identifikues ID të nxënësit, që ka dhënë provimin e Maturës Shtetërore, dhe që regjistrohet në sistemin e të dhënave pranë AKP-së. Ky është një standard i ri cilësor që e përfaqëson shumë Maturën shqiptare me atë të vendeve të tjera, rrit cilësinë e studentëve në hyrje, për pranim në shkollën e lartë, ndikon drejtpërdrejt në rritjen e cilësisë së studimeve universitare dhe lehtëson pranimin e studentëve shqiptarë në shkollat e larta të huaja dhe mobilitetin e studentëve në tërësi.
- ✚ Në kurrikulën e arsimit të mesëm të përgjithshëm është shtuar si lëndë me zgjedhje këtë vit, lënda “Financat Personale” e cila realizohet në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Shqipërisë që ofron ekspertizën dhe trajnon mësuesit përkatës në shkollat e mesme. Është aktualisht në proces përgatitja e programit modular për lëndën e Sipërmarrjes përfshirë në kurrikulën me zgjedhje të arsimit të mesëm, në funksion të përgatitjes për tregun e punës.
- ✚ Mësuesit kanë një status dinjitoz në shoqërinë tonë. Pagat e tyre u mbidryfishuan në 6 vjet dhe rritja e tyre do të vazhdojë.
- ✚ Investimet e bëra për trajnimin e vazhduar të mësuesve kanë rritur shkallën e kualifikimit të personelit mësimor dhe cilësinë e mësimdhënies.
- ✚ **Sfida kryesore në arsimin e mesëm të përgjithshëm** vazhdon të mbetet cilësia me standarde bashkohore teknologjike dhe përafrimi i kurrikulës së klasës 10-12 në përputhje me tregun e punës.

Shpenzimet korente të këtij programi janë planifikuar 4.33 miliard lekë ose 85% e shpenzimeve për këtë program buxhetor;

Buxheti në këtë program detajohet për 38 DAR/ZA dhe tre institucione nacionale, si Agjencia Kombëtare e Provimeve Tiranë (AKP), Instituti i Zhvillimit të Arsimit (IZHA)

Shpenzimet për “Pagat dhe sigurimet shoqërore”, janë realizuar në masën 99 % ose **3 miliard e 78 milion lekë** për rreth 5,808 punonjës nga të cilët 5,121 punonjës mësimorë dhe 687 punonjës ndihmës për shërbime mbështetëse, për rreth 118 842 nxënësve në arsimin e mesëm (gjimnazet)

Shpenzimet operative në artikullin **602- 606. janë 130.3 milion lekë ose 1.8%** e shpenzimeve korente, realizimi i shpenzimeve është në masën **128.9 milion lekë** ose 99% ku përfshihen;

Shpenzime për DAR/ZA për blerje mjetet didaktike e materiale te tjera mësimore, ne vleren **16 milion lekë**,
 Shpenzime për trajnime personeli e te ngjashme – **20 milion lekë**,

- ✚ Shpenzime për AKP - **41.3** milion lekë (Shpenzime për aktivitete për maturën shtetërore)
- ✚ Shpenzime për IKT – **3.2** milion lekë,
- ✚ Shpenzime për blerje dokumentacion shkollor, **3 milion lekë**,
- ✚ aktivitete ekstrakurrikulare, olimpiada kombëtare apo ndërkombëtare, konferenca në MASH, **1 milion lekë**
- ✚ Shpenzime për vleresimi i teksteve shkollore si dhe veprimtaria e BOMIT 2010 libri shkollor, **2 milion lekë**, (për tu paguar në vitin 2012)
- ✚ Shpenzime për **aktivitete në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi** në arsim **13.5** milion lekë Përgatitjen për implementimin e skemës së financimit të shkollave përmes granteve, fillimisht të pilotuar në shkolla. Forcimin i Qendrës së Provimeve nëpërmjet trainimit të stafit dhe zbatimit të një sistemi të ri administrativ, logjistik dhe teknik. Realizimi **12.3 milion leke** ose 91% e fondeve të planifikuara.
- ✚ **Shpenzime për në artikullin 606**, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 15 mijë nxënës **30.4 milion lekë dhe realizimi 30.3 milion lekë ose 100% e fondeve të planifikuara.** U dhanë falas tekstet shkollore për të gjithë nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale, pra u rimbursuan 100%.

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Mesem te Përgjithshëm, janë 751.4 milion lekë, (nga të cilat 385.5 milion lekë financim i brendshëm dhe 365.9 milion lekë financim të huaj)

Projektet kryesore janë;)

- ✚ Investime pjesë e fondit të zhvillimit të rajoneve 2011, janë planifikuar 216.5 milion lekë përfshirë detyrimet ndaj vitit 2010 për objektet në vazhdim për rreth 47.6 milion lekë, realizuar për 9-mujorin 45.3 milion lekë, 17 objektet e reja për financim në vitin 2011 për rreth 142.6 milion lekë, realizuar me 132 milion leke .
- ✚ Investime në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlerë financimi 494.9 milion lekë, të realizuara në total me 462.6 milion lekë
- ✚ Ndërtime të reja - 5 shkolla me 369.6 milion lekë (në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim) me realizim për vitin 2011 në vlerë prej 360.7 milion lekë
- ✚ Pajisje laboratorike janë 41.6 milion lekë në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim, realizuar 100%, ose 41.6 milion lekë.;
- ✚ Mobileri per laboratore shkencore 12 milion leke në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim realizuar 100%, ose 12 milion lekë.
- ✚ Pajisje kompjuterike ne kuader te projektit “Cilesi dhe barazi ne arsim” me vlerë 13.1 milion leke, realizuar 9 milion lekë..
- ✚ Lidhja me internet - 29.9 milion lekë, realizuar 29.8 milion lekë
- ✚ Pajisje mobileri per shkollat e ndërtuara në kuadrin e programit Cilësi dhe Barazi në Arsim me vlere 28.5 milion leke, alokuar pushtetit vendor për mobilimin e tre shkollave të mesme, realizuar vetem ne nje prej tyre 9.4 milion lekë ;
- ✚ Krijim fondi per bibliotekat me vlere 20 milion leke jane realizuar 19.3 milion leke
- ✚ TVSH për projektet e huaja në arsimin e mesëm të përgjithshëm 20 milion lekë, realizuar 10 milion lekë.

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011, në këtë program është në masen 98 % lekë ose në masën 98 % dhe përfaqëson rreth 13.6% të totalit fondeve të planifikuara për MASH dhe 13.9% të fondeve të realizuara për MASH.

Krahasuar me planin vjetor sipas produkteve të planifikuara për vitin 2011 rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korente	99%
<u>Shpenzimet kapitale</u>	89 %
Gjithsej	98 %

Në këtë program janë parashikuar per t’u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor paraqitet ne tabelën ne vijim:

Kodi i Produkt i	Emri i Produktit	Buxheti Vjetor 2011	Buxheti Vjetor Rishikuar 2011	Fakti 12mujor 2011	Realiz 12 mujor ne %
A	Shkolla te pajisura me laboratore shkencore	75,860.0	41,660.0	41,634	100%
A	Laboratore IT te pajisura me kompjutera ne AMP.	47,300.0	13,139.0	9,074	69%
A	Blerje pajisje per Kabinetet informatikes	0.0	12,000.0	11,960	100%

A	Shkolla/ klasa te pajisura me mobileri	63,000.0	28,500.0	9,393.0	33%
A	Shkolla te rikonstruata permes Projektit te KE me Bashkine e Tiranës	0.0	20,000.0	10,164	51%
A	Shkolla ne arsimin e mesem te reabilituara/zgjeruara	144,023.0	170,031.0	130,883	77%
A	Shkolla te reja te ndertuara sipas standardeve europiane	460,800.0	416,107.0	407,209	98%
A	Biblioteka te pasuruara me literature bashkekohore	37,200.0	20,000.0	19,286	96%
I	Instalimi i sherbimit te internetit dhe pajisjeve DEMO	95,400.0	29,986.0	29,805	99%
A	Trajnimi i mesuesve , per kurikulat e reja ne gjimnaze dhe zhvillimin profesional.	24,000.0	12,539.6	12,305	98%
B	Sigurimi i teksteve shkollore per nxenesit e arsimit te mesem te pergjith	33,000.0	30,422.0	30,287.7	100%
C	Vleresimi i nxnesve, matura shteterore	87,920.0	60,641.0	59,690	98%
D	Rishikimi i kurikules mesimore per K9-k12	27,000.0	24,500.0	24,406	100%
F	Krijimin i kushteve dhe shanseve te barabarta per te gjithë nxënësit për një arsim cilësor	4,427,175.0	4,385,575.7	4,338,893	99%
G	Realizimi i autonomise shkollore ne arsimin e mesem te pergjithshem.	0.0	0.0	0	0%
H	Veprimtari Ekstrakurikulare	3,800.0	2,200.0	2,200	100%
TOTALI		5,526,478	5,267,301	5,137,189	98%

Nga sa me siper, disa produkte nuk janë realizuar;

1. Sigurimi i teksteve shkollore për nxënësit e arsimit të mesëm të përgjithshëm procedurat janë në vijim.
2. Shkolla që përfitojnë autonomi financiare, procedurat janë në vazhdim;
3. Përgatitja e teksteve shkollore është në proces dhe ky produkt realizohet në periudhën Shtator 2011, deri tani është kryer vetëm procedura e vlerësimit të teksteve konkurruese.
4. Të gjitha produktet të planifikuara për vitin në grupin e investimeve kapitale nuk janë realizuar për shkak të mos miratimit të planit të buxhetit nga Ministria e Financës për vitin 2011,

Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12 mujorit 2011:

5. Shpërndarja me vonesë të fondit të zhvillimit të rajoneve për investimev për vitin 2011 me përfitues njësitë e pushtetit vendor, me ndikim në miratimi me vonesë i planit të investimeve për vitin 2011, si dhe zhvimimin e procedurave.
6. Miratimi me vonesë i planit të aktiviteteve në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, në muajin Mars nga bankat donatore dhe Prill nga MF, e për pasojë shtyrja e afatit të prokurimeve për realizimin e disa aktiviteteve në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, të cilat kanë zënë 50% në buxhetin e MASH.
7. Mosrealizim i procedurave dhe praktikave lidhur me programin e pilotimit të shkollave që përfitojnë autonomi financiare.
8. Rishikimi i buxhetit për vitin 2011, ka detyruar institucionet të ndërpresin kontratat ose të shtyjnë pagesat e detyrimeve të lindura në vitin 2011 për tu paguar/likujduar në vitin 2012. Disa nga aktiviteteve te projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim”, janë në proces procedurat e prokurimit për vitin 2011 dhe vazhdojnë në vitin 2012.
9. VKM nr.595, datë 24.8.2011 “Për disiplinimin e fondeve buxhetore për vitin 2011”.(Për fondet e planifikuara për trajnime jashtë vendit etj.)
10. VKM nr. 826, datë 5.12.2011 “Për një ndryshim në VKM nr. 929, datë 17.11.2010 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, ndryshimi i pikës 9-të në këtë vendim përjashton dhënien e shpërblimeve të punonjësve për rezultate në punë dhe veprimtari social- kulturore. (Ndryshimi i këtij vendimi në datën 17.11.2011 e bën të pamundur rialokimin e fondeve të planifikuara për shpërblie nga “Fondi i Vecantë” të rishpërndahen në programe apo aktivitete të tjera sepse bie ndesh me pikën 135 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”.

IV - ARSIMI I MESËM PROFESIONAL (Titulli i programit 09240).

Buxheti për vitin 2011 për këtë program është planifikuar **2 miliard e 315 milion lekë** dhe zë 6% të buxhetit të MASH, realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011 është në masën 83 % dhe zë rreth 5.2% të shpenzimeve të realizuara të MASH

Objektivat kryesorë për vitin 2011,

1. AP, ta ndjekin 28% e nxënësve të arsimit të mesëm.
2. Oferta e profesioneve të përputhet me kërkesat e tregut, vlerësuar me rritje 15 % e nxënësve të punësuar, (mbas 6 muajsh të përfundimit të shkollës) për çdo vit të PBA, dhe kjo behet e mundur edhe me ngritjen e sistemit të menaxhimit të informacionit (EMIS), krijimin e Eëb page dhe Netëorkut për AP ku shkollat

shkembejne eksperiencia, pasqyrojnë hollesisht profilet që përgatitin dhe ku bizneset gjejnë specialistë të rinj sipas veçorive të tyre.

3. Ritja e cilesisë së mësimdhenies mesimnxenies dhe kushteve të shkollave e konvikteve ku perfitues do jene afro 25000 nxenes, permes pajisjes se 25 shkollave me laboratorë virtual; Instalimit te 30 laboratorëve kimi-biologji, fizike dhe informatike; krijimit te 4 reparteve të reja elektronikes dhe pajisjes se 2 shkollave artistike me mjete per praktikat artistike dhe terheqjes se mesueve dhe specialisteve te kualifikuar.
4. Rritja e numrit të nxënësve edhe nga zonat rurale te vendit duke i mbështetur me politika favorizuese e sociale dhe favorizimi i nxënësve ne nevojë permes dhenies se 1600 bursave te reja, sidomos për ato në degët Bujqësi, Blegtori e Ndërtim, per cdo vit te PBA.
5. Akreditimi i 5 shkollave sipas standardeve AKAFP, per çdo vit te PBA dhe perputhja e kurrikulave me Kornizen europiane te kualifikimeve, permes rishikimit te 50 skelet-kurrikulave të kualifikimit profesional për klasat 2, 3, 4; dhe i skelet-kurrikulave të kualifikimeve të reja prof. e social-kulturore për klasat 2, 3, 4; Hartimi i 10 programeve për lëndët teknike profesionale e social kulturore.
6. Zhvillimi i tre profileve parësore në ekonominë e vendit, në arsimin pas të mesëm me kurrikula në përputhje me nivelin e pestë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve.

Arritje 2011

- ✚ Modernizimi i arsimit profesional është prioriteti numër një i Ministrisë për vitin 2012. Reforma në këtë sistem synon të përshtatë programet dhe degët e shkollave profesionale në funksion të kërkesave të ekonomisë dhe tregut të punës. Mbështetur në ligjin e ri “Për arsimin dhe formimin profesional”, të miratuar në vitin 2011, shkollat profesionale do të transformohen në qendra të hapura gjatë gjithë ditës, ku do të mësojnë jo vetëm nxënësit e rregullt, por edhe të rinj, të cilët, për shkaqe të ndryshme, kanë filluar të punojnë, si dhe të rriturit që dëshirojnë të formohen në një profesion. Reformimi i arsimit profesional do të jetë prioriteti kryesor i ministrisë në kuadër të programit IPA të BE-së.
- ✚ Investimet në arsimin profesional u përqëndruan kryesisht në rritjen e numrit të nxënësve që ndjekin drejtimin tekniko-profesional, rritjen e ofertave të kurrikulave dhe profileve në shkollat profesionale që reflektojnë kërkesat në tregun e punës, rritjen e cilësisë dhe modernizimin e infrastrukturës fizike dhe laboratorike (punishtet për mësim praktik) në shkollat profesionale. Janë dukë u rindërtuar 5 shkolla profesionale me fondet e Bashkimit European (IPA); vijon puna për ndërhyrjen/rikonstruksionin dhe në 2 shkolla të tjera. Janë pajisur 8 shkolla profesionale me fondet e Bashkimit European (IPA);
- ✚ Gjatë vitit shkollor 2011-2012 është ofruar për herë të parë programi me kohë të pjesshëm në arsimin e mesëm profesional për të gjithë ata që janë të punësuar në një profesion të caktuar dhe kërkojnë të formalizojnë kompetencat e tyre.
- ✚ U mbështetën me bursa të gjithë nxënësit konviktorë që ndjekin shkollat profesionale në degët TIK, bujqësi, ndërtim dhe pyje. Gjithashtu, u mbështetën me bursa të gjithë nxënësit konviktorë të vijnë nga 16 rrethe të zonave verilindore dhe juglindore të vendit dhe ndjekin shkollat profesionale.
- ✚ U dhanë falas tekstet shkollore për të gjithë nxënësit e komunitetit rom dhe u rimbursuan 100% ato për nxënësit e familjeve që marrin ndihmë sociale.
- ✚ Në vitin 2011 -2012, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ndërmori një fushatë intensive informimi për prindërit dhe nxënësit përmes projektit të Këshillimit të Karrierës, spoteve televizive, fletëpalosjeve, ditëve të hapura të organizuara nga shkollat në bashkëpunim me drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore (DAR/ZA), emisione televizive etj. Si rrjedhojë, promovimi i AFP solli një rritje prej 12 % të numrit të nxënësve të regjistruar në krahasim me vitin 2010. Ndikimin më të madh në këtë rritje e kanë drejtime mësimore të tilla si TIK, Shërbime mjetesh transporti, Ekonomi-biznes, Hoteleri-turizëm, Teknologji ushqimore dhe Elektroteknikë
- ✚ Me mbështetjen e projektit të Qeverisë së Konfederatës të Zvicrës filloi faza e tretë e projektit “Mbështetje për Arsim dhe Formim Profesional Shqiptar me fokus profilin e Termohidraulikës dhe IT”. Në kuadër të këtij projekti gjatë vitit shkollor 2011 -2012 filloi programi pilot pas i mesëm “IT praktike” e cila zhvillohet përmes bashkëpunimit të Universitetit të Durrësit dhe Shkollës Profesionale ‘Beqir Çela’ Durrës. Gjithasht, në 2011-2012 u hapën edhe dy programe të reja post sekondare “Menaxhim Veterinar” në filialin e Lushnjës, Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe “Teknik Laborant” pranë Universitetit të Elbasanit.
- ✚ **Modernizimi i arsimit profesional mbetet sfida kryesore në këtë sektor.** Në vazhdim, synohet të ndërhyhet në të gjithë sistemin e arsimit profesional për të fuqizuar ofertën e arsimit profesional, në nivel të

mesëm dhe post-të mesëm me degë të rëndësishme dhe profile teknike që kërkohen në tregun e punës dhe kështu rrisin nivelin e punësueshmërisë dhe të punësimit në Shqipëri

Shpenzimet korrente për këtë program janë planifikuar 1 miliard e 810.9 milion lekë. Realizimi i shpenzimeve korrente për periudhën 12 mujore ndaj planit vjetor, në këtë program është në masën 1 miliard e 748 .1 milion lekë ose 97 %. Buxheti është detajuar për 13 DAR, 10 ZA dhe 21 shkolla profesionale e socialkulturore me status kombëtar, si dhe 28 njësi të qeverisjes vendore.

Shpenzimet për pagat dhe sigurimet shoqërore (artikulli 600/601) janë planifikuar 1 miliard e 584.8 milion lekë për rreth 2, 226 punonjës(nga të cilët 1581 punonjës mësimorë dhe 645 punonjës për shërbime mbështetëse. Realizimi i shpenzimeve korrente për periudhën 12 mujore është në masën 1 miliard e 748 milion lekë ose në masën 97.2% ndaj planit vjetor

- ✚ Shpenzimet operative/korrente janë detajuar ne vleren 223.8 milion lekë, realizimi është në masën 205.3 milion lekë ose masën 92%, ku përfitues janë rreth 19 800 nxënës,
- ✚ Buxheti është detajuar për shkollat profesionale e social kulturore nacionale, DAR/ZA dhe Aparati i MASH për blerje materiale dhe mjete didaktike 71.6 milion lekë, Buxheti për për blerje materiale dhe mjete didaktike 71.6 milion lekë ose 100% e fondeve të planifikuara.
- ✚ Agjencia Kombetare e Arsimit dhe Formimit Profesional, Tirane 4.9milion lekë realizimi është 4.8 milion lekë ose në masën 100%;
- ✚ Shpenzime për kuota ushqimore bursat e nxënësve 137.2 milion lekë për afro 4700 nxënës, si dhe bursat për 84 nxënës të shkollës Austriake "Peter Mahringer" Shkodër rreth 12 milion lekë në total 149.2 milion lekë janë realizuar në masën 136.2 milion lekë ose 91% kundrejt planit 2011.
- ✚ Shpenzime për në artikullin 606, - Kompesimi i blerjes së teksteve shkollore për rreth 2500 mijë nxënës 9.8 milion lekë, janë realizuar në masën 6.5 milion lekë ose në masën 67% ku përfituan rreth 2000 nxënës.

Shpenzimet për investime kapitale në programin Arsimi Profesional janë 504.6 milion lekë, (nga të cilat 203.6 milion lekë financim i brendshëm dhe 301 milion lekë financim të huaj);

Projektet kryesore janë

- ✚ Rikonstrukcione për shkollat profesionale – 78.9 milion lekë realizuar 70.4 milion lekë
- ✚ Pajisje shkollore dhe mobilieri – 16.8 milion lekë, realizuar 12.7 milion lekë
- ✚ Pajisje laboratorike profesionale - 5 milion leke, nuk ka realizim
- ✚ Kabinete informatike - 25 milion leke, realizuar 25 milion lekë
- ✚ Laboratore virtuale - 3.9 milion leke, nuk ka realizim
- ✚ Pajisje teknologjike - 5 milion leke, nuk ka realizim
- ✚ Financimi i TVSH për projektet e huaja në arsimin e mesëm profesional 66 milion lekë, me realizim 63 milion lekë.
- ✚ Financim i huaj për ndërtimi e 5 objekteve shkollore nga projektet IPA 2008 – 164.8 milion lekë, nuk ka realizim
- ✚ Projekti i Qeverisë Zvicerane "Klasa per edukimin e alternuar " - 54.241 milion leke, nuk ka realizim
- ✚ Projekti i Qeverisë Zvicerane "Edukimi profesional shqiptar dhe program trajnimi" - 81.983 milion lekë, nuk ka realizim

Realizimi i shpenzimeve për 12 mujorin 2011 në këtë program është në masën 83 % dhe përfaqëson 6% të shpenzimeve të planifikuara dhe 5.1% të totalit të shpenzimeve të realizuara sipas zërave kryesore.

Krahasuar me planin vjetor sipas gru artikujve rezulton si më poshtë:

Shpenzimet korrente	97%
Shpenzimet kapitale	34 %
Gjithsej	83 %.

Në këtë program janë parashikuar per t'u realizuar produktet e mëposhtem, ecuria e të cileve krahasuar me planin vjetor jepet ne tabelë:

Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Buxheti Plan 2011	Buxheti i Rishikuar 2011	Fakti 12 mujor 2011	Realiz 12 mujor ne %
A	Pajisje mesimore te bazave prodhuese- didaktike nga Projekti KE_IPA)	6,022.0		0.0	0%
A	Laboratore mesimore te lendeve profesionale	28,974.0	9,000.0	4,000.0	44%
A	Konvikteve eksistues te rehabilituara	0.0	0.0	0.0	0%

A	Blerje pajisje mobilierie per klasat, labororet dhe kabintet e rinj.	9,640.0	13,350.0	7,247.6	54%
I	Blerje pajisje per krijimin labororeve te lendeve profesionale ne AMP (mbeshtetje prog IPA)	140,000.0	145,646.0	6,378.0	4%
J	Blerje pajisje elektronike per Krijimi i labororeve te infomatikes per AP.	26,000.0	28,900.0	25,000.0	87%
K	Ndertimi i shkollave Programi IPA (BE), per ndertimin dhe rikonstruksionin e shkollave Profesionale.	166,105.0	225,848.0	58,103.6	26%
L	Reabilitimi objekteve ne shkolla profesionale	112,469.0	79,384.0	70,759.0	89%
M	Reabilitimi objekteve ndertimore i bazave prodhuese didaktike	0.0	0.0	0.0	0%
N	Hartimi dhe dizenjimi i projekteve ndertimore, per shkollat e reja si dhe rikonstruksionet e objekteve te Arsimit profesional si dhe bazave mesimore e didaktike	0.0	2,483.0	2,482.6	100%
O	Pajisje per konviktet dhe Kuzhinat ne AP.	19,500.0	0.0	0.0	0%
A	Tekste te integruara per lendet profesionale	10,000.0	9,781.7	6,508.5	0%
B	Pergatitja e skelet-kurrikulave te kualifikimeve te reja profesionale dhe rishikimi i kurikules aktuale	5,000.0	5,000.0	0.0	0%
C	Zgjerimi dhe rritje e pranimeve ne AFP, nepermjet hapjes se programeve te reja te studimit ne perputhje me novoajat e tregut vendas, rajonal dhe me gjere	1,700,216.0	1,637,965.3	1,602,329.8	98%
D	Trajnimi i mesuesve qe i perkasin arsimit profesional e social-kulturor.	10,000.0	0.0	0.0	0%
E	Program e mesimore te permiresuara ne bashkepunim me biznesin.	3,000.0	0.0		0%
F	Akreditimi i drejtimeve te studimit/ shkollave nga AFP	33,108.0	19,506.5	15,553.5	80%
G	Trajnim i drejtuesve te shkollave, per perdorimin e pajisjeve informatike ne mesimdhënie etj.	1,500.0	1,500.0	1,500.0	100%
H	Mbeshtetje financiare me burse per nxenesit ne nevoje si dhe ne dege te rendesishme te ekonomise	203,000.0	137,168.0	122,121.6	89%
	TOTALI	2,474,534.0	2,315,532.4	1,921,984.2	83%

Nga tabela e mësipërme evidentohet se disa produkte nuk janë realizuar;

1. Shkolla që përfitojnë autonomi financiare, procedurat jane ne vazhdim;
2. Përgatitja e teksteve shkollore të integruara ky produkt është në proces dhe do të realizohet në vitin 2012.
3. Të gjitha produktet të planifikuara për vitin në grupin e investimeve kapitale nuk janë realizuar procedurat e prokurimit dhe lidhjen së kontratave. (për shkak të rishikimit të buxhetit vjetor 2011).
4. Për investimet në objektet e reja, apo kontrata në vazhdim me fondet e buxhetit të shtetit (janë duke u zbatuar procedurat e VKM nr. 135, datë 3.2.2010.

Faktorët që kanë ndikuar në realizimin e buxhetit për 12 mujorit 2011, janë spjeguar programet buxhetore të në arsimit bazë dhe në arsimit të mesëm të përgjithshëm.

V - INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË. (Titulli i programit 09450)

Buxheti i planifikuar për këtë program kapin vleren **6 miliard e 203.2 milion** lekë, reliazimi i shpenzimeve në këtë program është në shumën **5 miliard e 957 milion lekë ose 96%** e shpenzimeve të planifikuara. Shpenzimet e buxhetit te arsimit të lartë zënë 16% të buxheti të MASH dhe 16.1% të shpenzimeve të realizuara të MASH (*Fondet e realizuara te ardhurat e IAL 2.788 miliard lekë jane perjashtuar nga keto perllogaritje*)

Duke përfshirë dhe të ardhurat dytësore të IAL, plani në këtë program arrin 8 miliard 992.3 milion lekë ose 90 Milion \$USD dhe realizimi i shpenzimeve në programin e Arsimiti të Lartë për vitin 2011 është në masën 8 miliard e 745 milion lekë ose 97% e shpenzimeve.

Objektivat kryesorë

- 1). Përmirësimi i cilësisë së mesimdhënies për arritjen e standardeve të OECD, matur kjo me raportin student/pedagog, përmirësimin e metodave te mesimdhënies, rritjen e numrit të pedagogëve me 300, rritjen e numrit të labororeve shkencore dhe/ose përmirësimin dhe zgjerimin e tyre;
- 2). Të sigurohet cilësia e programeve të studimit, dhe implementimi i sistemit te krediteve per studentet e IAL-ve bazuar në kualifikimin standart të Bolonjës.
- 3). Të zgjerohet sistemi i AL përmes:
 - a) rritjes te së pranuarve nga shkollat e mesme me 6%;
 - b) dyfishimi i studenteve në deget e TI, permes hapjes së rreth 30 kurrikulave të reja të MP/Msc dhe 10 programeve studimi ne spec e PhD;
 - c) shtimit të studenteve ne TI dhe inxhineri me 13%;
 - d) Shtimin me 6% te numrit studenteve ne ciklin e dyte.
- 4). Rritja e autonomisë së IAL përmes,;
 - a) Rritjes se autonomisë adm e fin të IAL;

- b) rritjes se dimensionit social përmes tarifave të shkollimit të diferencuara, shtimit të bursave për studentët në nevojë;
- c) duke rikonstruktuar e ngritur godina te reja;
- d) ristrukt te god per 15000 studente;
- e) mbeshtetjes financiare per permiresimin e kushteve ne shtepite e studenteve,
- e) autonomise se IAL me synim rritjen e te ardhurave te tyre nga te tretet (vleresuar me rritje te % se GDP per AL);

5). Rritja e autonomise akademike, strukture, administrative dhe financiare të IAL-ve.

Arritje ne vitin 2011

- ◆ Për vitin akademik, 2011-2012, numri i pranimeve në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë ka shënuar një rritje prej 9% të pranimeve. Në institucionet publike të arsimit të lartë janë hapur 173 programe studimi të ciklit ët I-rë, II-të dhe III-të, ndërkohë që një sërë programesh janë në process vlerësimi.
- ◆ Në të gjitha institucionet e arsimit të lartë (IAL) shtimi i programeve të studimit është shoqëruar me shtimin e numrit të studentëve në të gjitha ciklet e studimit me rreth 5,500 studentë më shumë, ose 7.5% më shumë se viti i kaluar akademik, ku pranimet e reja në sektorin e arsimit të lartë privat zënë rreth 9%. Si rrjedhojë e rritjes së numrit të studentëve, janë hapur dhe ristrukturuar me standardet evropiane bibliotekat shkencore.
- ◆ Gjatë vitit 2011 u vlerësuan 7 Institucione të reja të Arsimit të Lartë (IAL) në kuadër të licensimit të tyre (2 IAL publike dhe 5 IAL private); u vlerësuan 104 programe të reja studimi të IAL publike dhe 179 programe të reja studimi të IAL private. Gjithashtu, në kuadër të akreditimit të tyre periodik u shqyrtuan dhe u kryen 7 vlerësime të Institucioneve të Arsimit të Lartë, (vlerësime në rang universiteti/ Fakulteti) dhe 61 vlerësime të programeve të studimit (BSc, MSC, MP) si dhe janë në proces akreditimi 11 institucione dhe 106 Programe studimi (BSc, MSC, MP).
- ◆ Në vitin 2011 janë financuar **32 laboratorë shkencorë e didaktikë**, në funksion të zhvillimit modern të mësimdhënies dhe të përgatitjes së studentëve. Përmes fondeve të kërkimit shkencor, gjatë 2011-2012, u mbështetën **53 projekte kërkimore shkencore** që u shërbejnë edhe studentëve të doktoratës. Projektet e gjuhës dhe të historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike u mbështetën me përparësi.
- ◆ Në kuadër të decentralizimit në IAL u zbatua modeli i financimit të kërkimit bazë (“fond për cdo kërkues dhe pedagog” në nivel departamenti, duke u mundësuar kërkuesve shkencorë të departamenteve të përzgjedhin dhe të vendosin vetë projektet që do të mbështeten.
- ◆ Në shtator 2011 është ndërmarrë **platforma** e emërtuar “**Këshillimi i karrierës**”, e cila ka orientuar qartë nxënësit që dëshirojnë të ndjekin studimet e larta. Janë organizuar në IAL-të publike takime konsultative dhe informuese rreth programeve të studimit të ciklit të parë me kohë të plotë që ofrojnë institucionet e arsimit të lartë, publike apo private.
- ◆ Në nëntor 2011, u lancua Thirrja e Pestë për aplikim e **programit Tempus IV**. Në këtë kuadër, Zyra Tempus ka zhvilluar dhe do të vazhdojë të zhvillojë në muajin dhjetor disa sesione informative në IAL publike dhe private për aplikimin me projekte Tempus për vitin e ardhshëm (Tiranë, Shkodër, Elbasan, etj). Gjatë vitit 2011, janë përzgjedhur dhe kanë filluar zbatimin 5 projekte (të tipit projekte të përbashkëta) nga 28 aplikime të bëra në shkurt 2011. Në muajin shtator 2011, përfaqësuesit e universiteteve partnere nënshkruan kontratat e financimit me Komisionin Evropian.
- ◆ Për vitin 2011, u realizuan 19 mobilitete për cikle të plota të studimi master ose PhD në kuadër të Aktivitetit të parë **Erasmus Mundus** “Programet e përbashkëta për master dhe doktoratë, ku përfshihen dhe aplikimet për bursa”. Gjithashtu, janë realizuar 84 mobilitete për periudha të pjesshme studimi dhe për shkëmbime stafi administrativ të realizuara në kuadër të Aktivitetit të Dytë të Erasmus Mundus. (46 nivel bachelor, 18 nivel master, 7 nivel PhD, 5 nivel post doc dhe 8 staf administrativ). Përzgjedhja e tre universiteteve shqiptare (Universiteti i Tiranës dhe Universiteti i Elbasanit) në partneritetet e Aktivitetit 2 do të shtojë ndjeshëm numrin e mobiliteteve nga niveli bachelor deri në nivelin postdoktoratë.
- ◆ Në kuadër të **reformës në arsimin e lartë** janë realizuar studime të hollësishme mbi modelin e financimit, kredinë studentore, procesin akademik, procesin e kërkimit shkencor, burimet financiare infratrakturore dhe

kapitalin njerezor, instrumentat e sigurimit të cilësisë, kapacitete menaxheriale të institucioneve të arsimit të lartë, zhvillimi i qendrave rajonale të zhvillimit pranë universiteve rajonale si dhe modernizimi i procesit të mësimdhënies.

- ◆ MASH ka organizuar diskutimin e gjërë publik me gjithë grupet e interesit të Planit Kuadër të Reformave në Arsimin e Lartë, nëpërmjet takimeve dhe konferencave publike. Gjatë muajve tetor-nëntor 2011, janë zhvilluar dy aktivitete të rëndësishme: *Konferenca kombëtare* për prezantimin të dokumentit “Reforma në Arsimin e Lartë - Plani Kuadër i Veprimit” me përfaqësues të Bankës Botërore në Shqipëri, ekspertë dhe konsulentë të huaj të reformës në arsimin e lartë, drejtues të universiteteve dhe fakulteteve. Gjithashtu u zhvillua një panel me eksperte të njohur ndërkombëtar ndërkombëtarë, me mbështetjen e konsorciumit të bankave që mbështesin projektin CBA për të gjitha aspektet kryesore të reformës mbi bazën e dokumentave bazë të hartuar në kuadër të reformës.
- ◆ Në Agjencinë Kombëtare të Provimeve po ndërtohet Baza Elektronike e të dhënave të arsimit të lartë, që përfshin *Regjistrin Kombëtar të Studentëve*, ku çdo student i regjistruar në cdo shkollë të lartë, publike apo private, që nga viti akademik 2011-2012, në të tri ciklet e studimeve universitare do të ketë numrin kombëtar të identifikimit, përveç atij që ka marrë në universitetin ku studjon.
- ◆ Ndërkohë ka filluar projekti i digjitalizimit të procedurave të aplikimit për Maturën shtetërore dhe për pranimet në shkollat e larta.
- ◆ Në zbatim të detyrimeve të ligjit nr.10 171, datë 22.10.2009 “**Për Profesionet e rregulluara** në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, është miratuar rregullorja e provimeve të shtetit dhe paketa e akteve nënligjore, që rregullon procesin e ngritjes së komisioneve për hartimin e katalogut të pyetjeve, komisioneve të provimeve të shtetit, tarifave (VKM nr 812, dt. 10.11.2011) dhe gjithë elementët përbërës të dhënies së provimit. Kandidatët regjistrohen pranë ministrive dhe urdhrave përkatës, që janë përgjegjës për profesionet respektive (VKM Nr. 649, datë 14. 09.2011 “Për përcaktimin e listës së specialiteteve, nënspecialiteteve, apo specialiteteve plotësuese për profesionet e rregulluara”). Gjatë periudhës janar-shkurt 2012, Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) organizoi Provimin e Shtetit për degët Mjekësi dhe Farmaci, nëpërmjet teknologjisë dixhitale dhe në përputhje me standartet evropiane. Sesioni i parë i provimit të shtetit përfundoi me sukses të plotë dhe fitoi një besueshmëri të lartë tek publiku. Për herë të parë në Shqipëri u zhvillua dhe implementua një standard i mirëfilltë ndërkombëtar i provimit tërësisht dixhital, me zero korrupsion dhe transparencë maksimale.
- ◆ Është miratuar nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës Rregullorja mbi “Organizimin dhe Zhvillimin e Praktikave Profesionale për Profesionin e Rregulluar të Mësuesit” Nr. 3874, datë 14.07.2011 si dhe programi i praktikës profesionale për mësuesit e rinj, të cilët do t’i nënshtrohen provimit të shtetit, në mënyrë që të kualifikohen si mësues të licencuar. Sipas kësaj Rregulloreje, mësuesit e diplomuar në shkollat tona të larta do të mundën ta ushtrojnë profesionin e mësuesit vetëm pasi t’i nënshtrohen praktikës profesionale njëvjeçare (që ka filluar aktualisht prej datës 5 Janar 2012) nën asistencën e mentorëve, të cilët janë mësues që përmbushin kritere të caktuara, dhe pasi t’i jenë nënshtruar provimit të shtetit.
- ◆ Gjatë vitit 2011 u përpunuan **1800 kërkesa për njohje diplome**. Për herë të parë, këto kërkesa u realizuan një afat të shkurtër kohor. Për cdo diplomë u përpunua dhe u përgatit dokumentacioni i nevojshëm brenda një afati 10 ditor nga data e regjistrimit në MASH. Gjithashtu, në 2011 filloi funksionimi i database-s së diplomave të njohura.

Buxheti i shpenzimet korrente të planifikuara prej 5 miliard e 643.7 milion lekë është realizuar në masën 98% ose 5 miliard e 553 milion lekë.

Buxheti është detajuar në 12 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, dhe 4 institucione të sistemit të arsimit të lartë, për afro **110 mijë** studentë në drejtime të ndryshme studimi.

Shpenzimet për zërin “pagat dhe sigurimet shoqërore të punonjësve në artikullin 600/601” janë planifikuar 4 miliard 473.1 milion lekë milion lekë për punonjesit e 12 Universitete dhe shkolla të tjera të larta, si dhe katër institucioneve si Qendra Studimeve Albanologjike Tiranë, Agjensia e Akreditimit Tiranë, Klubi Sportiv Studenti, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, realizimi për periudhën 12 mujore është në masën 99% ose 4 miliard e 408.7 milion lekë

- ◆ **602.shpenzimet operative** ku përfshihen shpenzimet e funksionimit (QSA, KS, SHBLU, AA) janë **150.8** milion lekë dhe realizimi është në masën 147.9 milion lekë ose 98%, **nga të cilat aktivitete në kuadër të projektit “Cilësi dhe Barazi në Arsim” janë planifikuar 63 milion lekë dhe janë realizuar 61.5 milion lekë ose 97%.**
- ◆ **Për institucionet publike të arsimit të lartë (IAL),** shuma prej **4 miliard e 579.8 milion lekë** (kapitulli 08, artikulli 600-606,) realizimi i shpenzimeve me burim transfertën e pakushtëzuar është në masën 4 miliard e 503 .8 milion lekë ose 98% e planit 2011. Kjo shumë paraqet shumën totale të marrë nga buxheti për “transfertën e pakushtëzuar” me një shkallë rritje prej 10% ndaj buxhetit të vitit 2010.(pas vendimeve të KA të IAL përdorimi i fondeve të pakushtëzuara është raportuar në kapitullin 08, sipas artikujve buxhetore 600-601-602-605-606) Fondet për universitetet janë rialokuar në formën e grantit të pakushtëzuar. Universitetet nëpërmjet organeve kolegjinale detajojnë këtë grant sipas njësive shpenzuese dhe zërave përkatës të buxhetit për pagat e punonjësve **4 miliard 296.7** milion lekë ose rreth **93.8%** e transfertës së pakushtëzuar, për shpenzime përsonele paga dhe sigurimet shoqërore e shëndetsore dhe **282.9 milion lekë** ose rreth 6.2% e transfertës të pakushtëzuar për shpenzime korrente nga të cilat janë realizuar 269.3 milion lekë ose rreth 95%.
- ◆ **Shpenzimet për artikullin 603. Subvencionet** tetë Sh.a “Trajtimi i Studentëve” në Tiranë dhe në rrethe janë **380 milion** lekë për rreth 14.500 studentë që akomodohen në mjediset/godinat e tyre, realizimi është në masën **380 milion lekë ose 100%.**
